

1. Aktiviteti kërkimor i Departamentit të Drejtësisë

Departamenti i Drejtësisë zhvillon një veprimtari të qëndrueshme dhe dinamike kërkimore-shkencore, e orientuar drejt trajtimit të çështjeve bashkëkohore juridike dhe sfidave të zhvillimit të sistemit ligjor shqiptar në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Aktiviteti kërkimor përqendrohet në fushat e së drejtës publike, private, penale, ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut, me theks të veçantë në reformën në drejtësi, qeverisjen e mirë, shtetin e së drejtës, barazinë gjinore dhe mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive themelore.

Stafi akademik i departamentit kontribuon në mënyrë aktive përmes publikimeve shkencore në revista dhe botime akademike, pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe organizimit të aktiviteteve shkencore, seminareve, tryezave të diskutimit dhe leksioneve të hapura me karakter akademik dhe profesional. Një rol të rëndësishëm në forcimin e dimensionit ndërkombëtar të kërkimit luajnë edhe programet e mobilitetit Erasmus+ dhe bashkëpunimet me institucione partnere brenda dhe jashtë vendit. Përmes këtyre angazhimeve, Departamenti i Drejtësisë synon të forcojë profilin e tij akademik dhe shkencor, të zgjerojë bashkëpunimin institucional dhe ndërkombëtar, si dhe të rrisë ndikimin e kërkimit shkencor në zhvillimin e politikave publike, edukimit juridik dhe progresit shoqëror.

2. Infrastrukturë kërkimore (laboratorë)

Departamenti i Drejtësisë disponon një infrastrukturë kërkimore që mbështet zhvillimin e aktivitetit shkencor dhe akademik në fushat e së drejtës publike dhe private. Biblioteka universitare “Barleti” ofron literaturë juridike bashkëkohore dhe materiale të specializuara, ndërsa aksesimi në platformën JSTOR mundëson përdorimin e burimeve dhe artikujve shkencorë ndërkombëtarë.

Aktiviteti kërkimor zhvillohet gjithashtu në sallat e leksioneve dhe seminareve të pajisura me infrastrukturë bazë teknologjike, të cilat shërbejnë për organizimin e diskutimeve shkencore, prezantimeve akademike dhe punës kërkimore të stafit dhe studentëve. Një rol të veçantë në infrastrukturën kërkimore të departamentit zë Klinika e Ligjit dhe studiot ligjore partnere, të cilat funksionojnë si mekanizma ndërlidhës ndërmjet teorisë juridike dhe praktikës profesionale. Përmes ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe përfshirjes së studentëve në trajtimin e rasteve konkrete, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive kërkimore, analitike dhe praktike të studentëve, si dhe në forcimin e komponentit të kërkimit të aplikuar dhe angazhimit social të departamentit.